



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT

Nr. 408/1 prot.

Tiranë më 24.2.2022

Lënda: Mendim mbi projektligjin “Për ratifikimin e Protokollit ndryshues të Konventës për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Tiranë

Në përgjigje të shkresës tuaj, nr.1050 Prot., datë 18.02.2022, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, shprehet dakord me projektligjin “Për ratifikimin e Protokollit ndryshues të Konventës për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”.

Ndërkohë, do të kërkonim nga ana juaj, kryerjen e ndërhyrjeve të nevojshme ligjore në funksion të pikës 2 të nenit 4 në harmoni me nenin 38, pikës 3 të nenit 21, dhe pikës 4 të nenit 37 të Protokollit Ndryshues të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

